



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

DOKUMENTI I RREGULLORES

PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR PROJEKTIN "NDËRTIMI I
FABRIKËS SË PASURIMIT TË KROMIT" ME VENDNDODHJE NË SURROJ,
BASHKIA KUKËS

MIRATOHET
KRYETARI I K.K.T.

Z. EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE

Znj. EGLANTINA GUERMINI

Ministër i Zhvillimit Urban



Z. DAMIAN GJIKNURI

Ministër i Energjisë dhe Industrisë



Miruar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.11, datë 09.09.2015

Projektues: Ing. Genci Madhi Nr. Lic. K0517/2
Projektues: Ing. Genci Gjoca Nr. Lic. M1139/1

GENC MADHI

VLERËSUES PASURISHT

INGENIER 0044

STRUKTOR LIC. K. 0517

Handwritten signatures and initials

TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES


1. Dispozita të Përgjithshme
 - 1.1 Baza Ligjore
 - 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar
 - 1.3 Përkufizimi i termave të përdorur
2. Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT)
 - 2.1 Orientimet dhe Detyrimet që rrjedhin nga IPV
 - 2.2 Rregullat, normat dhe standartet e zhvillimit
 - 2.3 Seti i fragmenteve të hartave të IPV për zonën në zhvillim
3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)
 - 3.1 Informacion për topografinë e zonës.
 - 3.2 Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tilla)
 - 3.3 Informacion mbi zona të mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore dhe historike
 - 3.4 Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj
 - 3.5 Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistuese
4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit
 - 4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ose parcelave
 - 4.2 Hapësira e zënë me ndërtesa
 - 4.3 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Trajtimi i Mbulesave
 - 4.4 Normat e zhvillimit
 - 4.5 Përcaktimin e treguesve për zhvillim për secilën parcelë
 - 4.6 Vendqëndrimi për automjetet
5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës
 - 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave
 - 5.1.1 Rrjeti Rrugor
 - 5.1.2 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike
 - 5.1.3 Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit
 - 5.1.4 Rrjeti i shkarkimit të ujrave të zeza
 - 5.1.5 Rrjeti i furnizimit me ujë
 - 5.1.6 Rrjeti i shkarkimit të ujrave të shiut
 - 5.2 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta
6. Fazat e Zhvillimit të Lejes së Ndërtimit
7. Relacionin e menaxhimit të inerteve të dalta si rezultat i punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit.

GENÇ MADHI
VLERESUES PASURISH
NR. LICENCE 0044
CONSULTOR LTD, K. 0517
[Signature]

8. Impaktet Kryesore në Mjedis

- 8.1 Impakt mbi sipërfaqen e tokës
- 8.2 Impakt mbi ujërat sipërfaqësore
- 8.3 Impakt mbi ujërat nëntokësore
- 8.4 Impakt mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)
 - 8.1.1 8.4.1 Flora dhe Fauna
 - 8.1.2 8.4.2 Habitatet (Objektet me status të cilësuar)
- 8.5 Impakt mbi menaxhimin e tokës dhe mbetjeve
 - 8.1.3 8.5.1 Mbetje të ngurta
 - 8.1.4 8.5.2 Sterile të procesit teknologjik
- 8.6 Impakt mbi Peizazhin
- 8.7 Impakt mbi Zhurmat dhe ajrin
 - 8.1.5 8.7.1 Ndikimi në zhurma dhe vibrimet
 - 8.1.6 8.7.2 Ndikimi në ajër
- 8.8 Impakt mbi trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë

9. Anekse (Hartat në format A3)

GENC MADHI
VLERESUES PASURISH
NR. LICENCE 0044
INSPEKTOR GJENOR K. 0517
3


1. Dispozita të Përgjithshme

Shoqëria "Vllaznimi Deda Import-Export" sh.p.k është themeluar në datën 20.02.1995 me vendimin e Gjykatës së Tiranës, Nr. 9029, me NIPT i shoqërisë është J78716319A.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj kryesisht në fushën e nxjerrjes së mineralit të kromit, në ndërtim dhe në shfrytëzimin pyjor. Shoqëria ka leje dhe kryen operacione të nxjerrjes së mineralit të kromit dhe ka hapur degë të saj në Manazdren, Vinjoll, Burrel; Virth, Lezhë dhe Truall, Surroj, Kukës. Nga viti 2007 e në vazhdim prodhimi dhe eksporti i mineralit të kromit ka zënë 35 deri 45% të volumit të xhiros vjetore, ndërsa për vitin 2015 parashikohet që eksporti i mineralit të kromit të zejë mbi 55% të xhiros vjetore.

Ndër objektet e shumta që ka relizuar kjo shoqëri janë: Rikonstruksioni i Fabrikës së Pasurimit Bakrit Fushë-Arrës për llogari të kompanisë Bechtel-Enca, ndërtimi i HEC në Dardhë të Pukës, financuar nga firma franceze Venerg, ndërtim të shumë ujësjellësave, ndërtim rrugësh dhe shumë ndërtime dhe rikonstruksione të ndryshme.

Aktualisht shoqëria "VllaznimiDeda" sh.p.k. ka një kapacitet teknik dhe financiar të mjaftueshëm për përballimin dhe kryerjen e investimit të paraqitur.

1.1. Baza Ligjore

Për planifikimin

- Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar;
- Vendim i KM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar.

Për mjedisin

- Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 "Mbi lejet mjedisore";
- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 " Mbi mbrojtjen mjedisore";
- Ligji nr.10440, datë 07.07.2011 "Mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor";
- Ligji nr.10463, datë 22.09.2011 "Mbi manaxhimin e mbetjeve të integruara";
- Ligji nr. 8906, datë 06.06.2002 " Për zonat e mbrojtura";
- Ligji nr. 9868, datë 04.02.2008 " Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906, datë 06.06.2002 " Për zonat e mbrojtura";
- Ligji nr. 9983, datë 08.09.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8934 datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së eger";
- Ligji nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit";
- Ligji nr. 111/2012 "Për manaxhimin e integruar të burimeve ujore".
- Vendim i KM nr. dt. 04.01.2013 " Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis.
- Udhëzim nr.3, datë 02.12.2013 "Për VNM dhe lejet e Mjedisit"
- Udhëzim nr.6, datë 27.12.2006 "Për miratimin e metodologjise së vlerësimit paraprak të ndikimit në Mjedis".

1.2. Përshkrim i zonës së studiuar

Zona në studim është pjesë e Fshatit Surroj, Kukës. Vetë fshati Surroj me reformën e re territoriale është pjesë e Bashkisë Kukës. Është në përgjithësi një zonë malore me lumenj dhe përrenj që e përshkruajnë të gjithë zonën.

GENC. MADHI
VLERESUES PASURISH
MR. LICENCE 0044
"CONSTRUKTOR" LI. K.40517

Fshati Surroj është i vendosur në jugperëndim të qytetit të Kukësit. Territori i këtij fshati përbëhet pothuajse tërësisht nga male të larta dhe kodra, ndërsa zona ku do të ndërtohet fabrika është shumë pak e banuar. Aktivitetet kryesore të zonës rreth e qark janë bujqësia dhe blegtoaria, por gjithashtu banorë të këtyre fshatrave punojnë edhe në minierat e kromit që kryejnë aktivitet në këtë zonë.



Fig 1- Zona e parcelës për ndërtim

Zona ku do të zhvillohet parcela ndodhet në afërsi të fshatit Surroj, Bashkia Kukës. Parcela në studim është pozicionuar në pjesën jug-perendimore të qytetit Kukës, në një zonë thuajse të pabanuar dhe me fshatin më të afert Fushe-Arrë, që ndodhet në një distancë më të madhe se 2 km prej sheshit të zgjedhur për ndërtimin e objektit. Në afërsi të zonës ndodhen vetëm miniera që nxjerrin mineral kromi dhe hekurit për eksport ose për prodhimin e ferrokromit. Zona është e aksesueshme nga një rrugë që përdoret nga banorët e fshatit dhe minierat e kromit dhe hekurit. Rruga është në gjendje jo të mirë teknike. Ajo lidhet me rrugën kombëtare Tiranë - Kukës. Distanca e vendit të ndërtimit të kësaj fabrike nga rruga kryesore është rreth 4.5 km. Kjo rrugë do të riparohet nga shoqëria "Vllaznimi Deda Import-Export" sh.p.k para fillimit të punimeve dhe do t'u shërbejë edhe banorëve të zonës. Gjithashtu në afërsi të zonës kalon edhe linja elektrike e tensionit të mesëm 10Kv, nga ku do të bëhet furnizimi i kësaj fabrike me energji elektrike.

Parcela ku do të zhvillohet Fabrika e Pasurimit të Kromit Surroj, përfshin një sipërfaqe prej 11.860 m², e cila do të merret me qira nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Kukës. Zona është thuajse krejtësisht e pazhvilluar, pa pyje dhe me livadhe thuajse të degraduar.

GENG KLABIZI
VEKTESUES PASURISH
LISENCE 0044
INSTRUKTOR LIGJ K 50517

Parcela kufizohet në:

Veri Parcela Pyjore 27a dhe 27b (pjesërisht e parashikuar për ndërtimin e fabrikës).
Lindje Parcela Pyjore 27a (pjesërisht e parashikuar për ndërtimin e fabrikës).
Jug Parcela Pyjore 31b (pjesërisht e parashikuar për ndërtimin e fabrikës).
Perendim Parcelat Pyjore 27b dhe 31b (pjesërisht e parashikuar për ndërtimin e fabrikës).

1.3. Përkufizimi i termave të përdorur

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

Fabrikë Pasurimi Një instalim makinash dhe pajisjesh brenda një strukture ndërtimore në të cilën lëndët e para përpunohen me metoda speciale për të realizuar një produkt të përshtatshëm për procese të mëtejshme ose për shitje. Në këtë projekt shërben për përfitim të koncentreve me përmbajtje të lartë të oksideve të kromit.

Linjë teknologjike Instalimi i një numri makinash dhe pajisjesh në vazhdimësi të njera-tjetrës për realizimin e një proces industrial të caktuar.

Lëvizje gravimetrike Në procese të caktuara përdoret rënia e lirë e materialeve duke shfrytëzuar forcën e gravitetit për të thjeshtuar dhe ekonomizuar procesin.

Pasurim gravimetrik Proçesi i ndarjes së mineraleve bazuar në diferencat e peshave specifike të tyre. Një proces pasurimi gravimetrik projektohet për të përfutur një përmbajtje të lartë të masës së dobishme që ndodhet në sasi të vogla në lëndën e parë.

Dampa e sterileve Një rezervuar i ndërtuar me ngritje anësore të dherave dhe që përdoret për depozitimin e sterileve që krijohen gjatë proceseve të pasurimit pas ndarjes dhe heqjes së pjesës së dobishme.

Koncentrat kromi Produkti që rezulton nga procesi i pasurimit pasi nga lënda e parë që përpunohet është larguar pjesa e padobishme. Sipas Standarteve Ndërkombëtare duhet që përmbajtja e Cr_2O_3 në këtë produkt të jetë nga 44% gjer në 52%.

Mbetje sterile Pjesa e parikuperuar dhe jo ekonomike e lëndës së parë që shkarkohet pas përpunimit me anë të ujit (në këtë projekt) në vendin e depozitimit të tyre, Dampë.

Shkëmbinj ultrabazikë Shkëmbinj bazë që përmbajnë më pak se 45% SiO_2 . Mineralogjia e shkëmbinjve është në përgjithësi e përbërë nga peridotitet dhe kimberlitet. Shkëmbinj të ultrabazikë janë përbërësit kryesorë të mantelit të tokës.

Sistemet e infrastrukturës Mjete themelore dhe linja që shërbejnë në një impiant apo fabrikë për furnizimin dhe ndihmojnë në kryerjen e aktiviteteve kryesore. Në këtë projekt janë të projektuara tre sisteme kryesore të infrastrukturës: sistemi elektrik, sistemi i furnizimit me ujë dhe sistemi i tubacioneve teknologjike.

Tubacioneve magjistrale Në këtë projekt përfaqëson linjën kryesore të furnizimit të fabrikës me ujë teknologjik.

GENC MADHI

VLERESUES PASURIMSH

NR. LICENCE 0044

STRUKTORI LIT. R. 0517

<i>Prurja totale nominale</i>	Sasia e ujit që rezulton në sistem pas vënies në punë të fabrikës.
<i>Prurja projektuese</i>	Sasia e ujit që merret në konsideratë gjatë projektimit të sistemit të furnizimit me ujë të fabrikës.
<i>Presioni i punës</i>	Presioni që realizohet nga stacioni qëndror i pompimit dhe që përfaqëson presionin e nevojshëm për kryerjen e procesit plus presionin e nevojshëm për përballimin e humbjeve hidraulike.
<i>Humbjet gjatësore</i>	Në një lëvizje reale të lëngjeve energjia që nevojitet për përballimin e fërkimit dhe turbulencave konvertohet në humbje që janë proporcionale me gjatësinë e tubacioneve dhe janë humbjet gjatësore hidraulike.

2. Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT).

Nga verifikimet e kryera, si dhe referuar faqes zyrtare të AKPT www.planifikimi.gov.al Njësia Administrative Surroj (Ish Komuna Surroj) nuk ka një Instrument Planifikimi Vendor të miratuar.

3. Analiza e Gjëndjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)

3.1. Informacion për topografinë e zonës

Sheshi, i cili do të nënshtrohet punimeve të ndërtimit dhe sistemimit ndodhet në një terren me pjerrësi rreth 20°, me drejtim juglindje-veriperendim dhe ndodhet ndërmjet kuotave 538m dhe 568m mbi nivelin e detit.

Parcela e vendosur në këtë terren të pjerrët, është e lirë dhe nuk ka asnjë ndërtim ekzistues në afërsi që mund të funksionojnë së bashku me ato që propozohen.

Zgjedhja e kësaj parcele është bërë për këto arsye kryesore: së pari ndodhet në afërsi të burimeve minerare, është e lidhur me rrugë automobilistike me rrjetin kombëtar rrugor, ka në afërsi të saj burime ujore të domosdoshme për procesin teknologjik si dhe pjerrësia e terrenit ndihmon në levizjen gravimetrike të materialeve gjatë procesit teknologjik.


3.2. Informacion për burimet natyrore dhe mjediset

Duke qënë se zona ku parashikohet zhvillimi nuk është e pajisur me Instrument Planifikimi, nuk ka parashikime të të tilla, që mund ti referojmë në këtë dokument.

3.3. Informacion mbi zonat e mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore edhe historike

Zona ku do të zhvillohet ndërtimi është një zonë e zhveshur që nuk është as me pyje dhe as me livadhe, por me shkurre të degraduara. Nga Studimi mbi "Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" i kryer nga specialistët e licensuar të kësaj fushe rezulton se nuk ka zona të mbrojtura natyrore në sheshin e ndërtimit si dhe në afërsi të tij.

Zona për zhvillim nuk ka objekte me status "monument kulture", "zonë historike" dhe as sipërfaqe me status "zonë arkeologjike" ose "zonë e mbrojtur" bazuar në studimet e kryera nga specialistët e licensuar për studimet arkeologjike dhe Drejtoritë përkatëse të Ministrisë së Kulturës. Këto janë të miratuara me vendimin nr. 104, datë 11.11.2014 të Ministrisë së Kulturës dhe me Shkresën nr. 348, datë 21.05.2015 të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.


GENE MADHI
VLERËSIMES PASURISH
 NR. LICENCE 0044
 INSTRUKTOR LIC. K. 0517

3.4. Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj

Zona ku do të bëhet ndërtimi i Fabrikës së Pasurimit është pa infrastrukturë ekzistuese për objekte industriale. Infrastruktura rrugore është shumë e dëmtuar. Parcela është e aksesueshme nga rruga Tiranë - Kukës në një distancë rreth 5 km nga Fushë Dukagjini në daljen që bëhet nga kjo rrugë për në Kalimash. Përparësi dhe një nga arësyet e zgjedhjes së këtij sheshi është afërsia e kësaj rruge me fabrikën që do të ndërtohet.

Përgjithësisht zona nuk ka mungesa të burimeve të ujit, kryesisht si zonë që shtrihet në anë të përroit të Leshnicës, i cili është një përrua që ka ujë të mjaftueshëm edhe në muajt më të thatë të vitit, por nuk ka asnjë infrastrukturë të furnizimit me ujë, as teknologjik, as ujë të pijshëm. Edhe infrastruktura e furnizimi me energji elektrike është e mangët por më e mirë se infrastruktura e rrugëve dhe furnizimit me ujë. Në afërsi të zonës ku do të ndërtohet fabrika, në një distancë rreth 600 m kalon linja e tensionit të mesëm 10 Kv Mamëz – Surroj, prej nga do të bëhet edhe furnizimi me energji elektrike i fabrikës me një linjë ajrore.

3.5. Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistues

Zona ku do të bëhet ndërtimi i Fabrikës së pasurimit Surroj si dhe është përmendur më lart nuk ka thujse asnjë infrastrukturë të nevojshme për një ndërtim të kësaj natyre dhe përmasash. Zonë është malore dhe pa ndërtime civile apo industriale.

Infrastruktura e zonës nuk ekziston, por do të krijohet, me sistem rrugor të aksesueshëm, por me rrjet të brendëshëm rrugor që do të krijohet si dhe me linjë elektrike që gjithashtu do të ndërtohet e re.



Fig 2- Rilevimi topografik

GJENÇI
VLERËSUES PASURISH

LICENCA
GJENÇI
INSTRUKTOR LIC, K. 0817

4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

4.1. Funkcionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ose parcelave

Sipërfaqja totale e parcelës prej 11.860 m² është tërësisht me funksion të fabrikës së pasurimit të kromit me sipërfaqe totale ndërtimi 4.900 m² dhe sipërfaqe gjurme 4.900 m². Parcela që do të zhvillohet do të përmbajë godinat e poshtëshënuara, bashkë me funksionet përkatëse:

G01 - Sheshi i Mineralit Fillestar (i Pranimit të Lëndës së Parë). Shërben për depozitimin dhe manipulimin e mineralit të kromit që do të përpunohet si për të krijuar përzierjet më të përshtatshme teknologjike ashtu edhe për të siguruar një punë pa ndërprerje të fabrikës për një periudhë tre mujore.

G02 - Bunkeri Pranimit dhe reparti thyerjes së parë. Në këtë repart bëhet thyerja primare e mineralit dhe sigurohet një punë pa ndërprerje e fabrikës për një turn.

G03 - Reparti i Thyerjes së dytë. Kryhet në këtë repart thyerja e imët e mineralit për ta bërë të përshtatshëm për repartin e bluarjes.

G04 - Reparti Sitisjes dhe Bunkeri i Akumulimit. Shërben për fraksionimin e produktit të thyer dhe për të siguruar punë të pavarur të pjesës tjetër të fabrikës në rast difektesh në repartet e thyerjes. Edhe bunkeri i akumulimit siguron një punë pa ndërprerje të fabrikës për një turn.

G05 - Reparti i Bluarjes. Shërben për bluarjen e mineralit duke bërë të mundur clirimin e kromit nga sterili. Ky repart ka dy mullinj me shufra dhe tri sita për të mundësuar minimalizimin e bluarjes së imët të mineralit gjë që mund të krijojë shllame dhe të shkaktoje ulje të rikuperimit.

G06 - Reparti Pasurimit. Në këtë repart bëhet ndarja e pjesës së dobishme nga sterili duke realizuar produktin e nevojshëm. Pasurimi bëhet në katër shkallë të njëpasnjëshme. dy nivele pasurimi me spirale dhe dy nivele të tjera pasurimi në tavolina koncentrimi. Për të bërë të mundur një pasurim më të mirë të mineralit në këtë repart sipas teknologjisë së projektuar përdoren edhe dy nivele separimi me hidrociklone dhe klasifikator hidraulik.

G07 - Vaska e Koncentratit. Shërben për depozitimin dhe kujëzimin e koncentratit të prodhuar të kromit.

G08 - Sheshi Depozitimit të Koncentratit. Shërben për depozitimin dhe manipulimin e koncentratit të prodhuar të kromit, mund të sigurojë një punë të pandërprerë të fabrikës për një periudhë tre mujore.

G09 - Dampa e Sterileve. Në këtë dampë do të depozitohen sterilet që do të rezultojnë nga procesi i pasurimit. Dampa parashikohet që të zhvillohet në dy faza, faza e parë njëkohësisht me ndërtimin e fabrikës, ndërsa faza e dytë pas pesë vitesh. Dampa do të shërbejë njëkohësisht edhe për filtrimin dhe pastrimin e ujit teknologjik i cili do të riciklohet në proces.

G10 - Stacioni i pompave të ujit. Shërben për furnizimin me ujë të fabrikës.

G11 - Peshorja e automjeteve. Shërben për peshimin si të mineralit që do të blihet nga subjekte të ndryshme ashtu edhe për peshimin e koncentratit.

G12 - Laboratori. Do të shërbejë për kryerjen e analizave jo vetëm të produkteve që përpunohen dhe të atyre që prodhohen, por gjithashtu edhe për të bërë analiza të procesit teknologjik.

GENC MADHI
VLERESHES PASURISH
Gene Gjoca
NR. LICENCE 0044
"INSTRUKTOR LIC. K. 0517

G13 - *Oficina*. Shërben për kryerjen e riparimeve të ndryshme dhe remonteve për një punë normale të fabrikës.

G14 - *Kabina e Transformatorit TN*. Shërben për uljen e tensionit të energjisë elektrike nga tensioni i lartë 10 Kv në tensionin e punës të paisjeve 380 V.

G15 - *Stacioni qëndror i pompimit të ujit*. Shërben për të bërë furnizimin me ujë të procesit teknologjik duke marrë ujin që ka kaluar në procesin e dekantimit dhe pastrimit në dampën e sterilizimit.

4.2. Hapësira e zënë me ndërtesa

Strukturat që do të zhvillohen në këtë zonë do të respektojnë ambjentin rrethues. Ndërtimi fillestar do të bëhet i zbuluar, do të ndërtohen vetëm bazamentet e makinerive dhe në një fazë të dytë mund të bëhet edhe mbulimi i tyre me konstruksione të lehta metalike dhe çati gjithashtu me konstruksion e kapriatë metalike. Objektet që do të ndërtohen do të ndikojnë në pejsazhin e zonës, por në mënyrën që do të zhvillohen jo vetëm që nuk do ta dëmtojnë këtë pejsazh, por mendojmë se do ta përmirsojnë duke krijuar një imazh të ri industrial.

Objekt i karakterit industrial është i zhvilluar në një kat të vetëm, pa kate nëntokësore. Lartësia e strukturës është jo më e vogël se 3.50 m, në repartet e ndryshme të fabrikës lartësitë përcaktohen nga kërkesat teknologjike.


Reparti i thyerjes së parë dhe reparti i thyerjes së dytë kanë lartësi respektivisht 7.5m dhe 5m. Reparti i Bunkerit të akumulimit dhe sitisjes ka një lartësi prej 10m. Reparti i bluarjes ka një lartësi maksimale prej 5m. Reparti i pasurimit ka dy lartësi: Pjesa ku ndodhen spiralet pasuruese është 14m e lartë, ndërsa pjesa ku ndodhen tavolinat e pasurimit është 3.5m e lartë.

Godinat do të jenë prej beton të armuar, me struktura të pambuluara dhe me makineri e konstruksione metalike të instaluar në të.

4.3. Pamja e jashtme e godinave/ Trajtimi i fasadave/ Trajtimi i mbulesave

Arkitektura është e thjeshtë dhe respekton linjat e pastra gjeometrike dhe kuadratike në strukturat e zhvilluara. Duke qenë një objekt industrial qëllimi kryesor është funksionimi normal i teknologjisë dhe puna pa ndërprerje e fabrikës, por duke respektuar edhe një harmonizim të reparateve, normat për hyrje-daljet dhe qarkullimin e njerëzve, automjeteve edhe mallrave, ngjyrat që duhet të përdoren, materialet që duhet të përdoren, lartësitë e ambjenteve etj. Fasadat e Laborator-Oficinës dhe Kabinat e Transformatorit dhe Peshores do të jenë me suva plastike ngjyrë gri e ndarë me fuga ngjyrë gri të errët.

Sipërfaqe të gjelbra janë jo vetëm sipërfaqet që do të ngelen pas ndërtimit të objekteve dhe rrugëve të brendshme 5.960 m², por edhe sipërfaqe të tjera në afërsi të fabrikës që nuk përfshihen në territorin e fabrikës (brenda lejes ndërtimore), por që gjithashtu do të pyllëzohen.


GENC MADHI
VLERE QIES PASURISH
NR. LICENCE 0044
KONSTRUKTOR LIC.10K.0517




Fig 3- Prerja gjatësore e Repartit të Bluarjes





Fig 4- Prerja tërthore e Repartit të Pasurimit


GENC MADHI
 VLERESUES PASURISH
 NR. LICENCE 0044
 KONSTRUKTOR LIC. M. 0517

4.4. Përcaktimi i treguesve për zhvillim për parcelën

Kategoria e propozuar e përdorimit të tokës	Industri
Sipërfaqja e parcelës	11.860 m ²
Sipërfaqja e gjurmës	4.900 m ²
Sipërfaqja e përgjithëshme e ndërtimit	4.900 m ²
Koeficienti i shfrytëzimit të territorit	41.0%
Sipërfaqe rrugësh	1.000m ²
Koeficienti i shfrytëzimit për rrugë	8.40 %
Sipërfaqe gjelbërimi	5.960 m ²
Numri i kateve mbitokë	1K
Numri i kateve nëntokë	0K

4.5. Rregullat e zhvillimit

Zona industriale duhet:

- të lidhet me të gjitha rrugët e trafikut të jashtëm;
- të respektojë distancat nga qendrat e banuara në varësi të llojit të aktivitetit dhe treguesve mjedisorë, sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm në fuqi;
- të rrethohet me breza mbrojtës sanitarë;
- të pozicionohet në mënyrë të tillë që shkarkimet në ajër të mos lëvizin me erën drejt qendrave të banuara;
- të ketë një rrjet të infrastrukturave të pavarur nga ai i zonës së banuar;
- të përmbajë edhe zonat dhe zgjidhjet e brendshme për trajtimin e mbetjeve të të gjitha llojeve që shkarkohen nga aktiviteti industrial.

4.6. Vendqëndrimi për automjetet / Parkimet

Në këtë objekt parkimet janë parashikuar së pari për mjetet e transportit të kompanisë dhe do të jenë në sheshin e Pranimit të Lëndës së parë, ndërsa automjetet e punonjësve do të parkohen në zonën e sheshit të Depozitimit të Koncentratit.

5. Rregullat e rrjeteve të infrastrukturës

5.1. Pozicionimet e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturës

Sistemet e infrastrukturës uji, tubacionet teknologjike dhe kanalizimet) do të vendosen në sipërfaqen e tokës dhe do të jenë të sistemuara në një korridor qendror infrastrukture, përgjatë repartit të bluarjes dhe më pas me degëzime në drejtim të reparteve të thyerjes dhe pasurimit të fabrikës.

Rrjeti elektrik do të kalojë në të njejtin korridor, por me ndryshimin se do të jetë ajror. Për sa i përket rrjetit inxhinierik përfshihen:

- rrjeti elektrik dhe ai i ndriçimit të rrugëve;
- rrjeti i furnizimit me ujë;
- rrjeti tubacioneve teknologjike.

5.1.1. Rrjeti rrugor

Rrjeti rrugor nuk do të jetë krejtësisht i ri për të bërë lidhjen e tij me rrugën ekzistuese që shkon në drejtim të fshatit Surroj nga rruga Tiranë - Kukës. Objekti ndodhet në afërsi të

GENC MADHI

VEPËRËS I ASORIT SH

0044

K. 12

rrugës ekzistuese, e cila do të riparohet nga shoqëria "Vllaznimi Deda" sh.p.k. Kjo rrugë do të shërbejë edhe për peshoren e automjeteve. Edhe rruga tjetër që do të përshkojë fabrikën është ekzistuese dhe gjithashtu vetëm do të riparohet. Gjatësia totale e rrugëve që do të riparohen dhe ndërtohen është rreth 250 m. Rrugët e tjera do të jenë provizore dhe do të shërbejnë vetëm për ndërtimin e objektit dhe montimin e makinerive. Rrugët e reja do të krijohen përgjatë ndërtesave që do të zhvillohen, së bashku me to do të ndërtohen paralelisht rrjetet e kanalizimeve, ujësjellësit, ujit teknologjik dhe elektrik.

5.1.2. Rrjeti i furnizimit me energji elektrike

Furnizimi i fabrikës me energji elektrike do të bëhet nga Linja Elektrike e tensionit të mesëm 10 Kv Mamëz - Surroj. Një degëzim i linjës elektrike do të futet në ambientin e kabinës së tensionit të lartë ku do të bëhet vendosja e paneleve të tensionit të ulët si dhe transformatori dhe paneli i matjes së energjisë elektrike në tensionin e ulët. Linjat e brendshme elektrike do të jenë kablllore ajrore.

5.1.3. Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit

Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit është realizuar në bazë të normave, rregulloreve dhe kritereve projektuese të vendeve të Komunitetit Europian si dhe në përputhje me rregulloret MKZSH në Shqipëri.

Për të përdorur agjentë shuarës të përshtatshëm gjatë procesit të mbrojtjes nga zjarri, në funksion të materialeve që mund të marrin flakë, janë marrë në konsideratë klasat e zjarrit. Në projekt janë përcaktuar me saktësi zonat sipas klasit të zjarrit dhe në përputhje me to janë zgjedhur lloji i fikseve portative (bombolave). Në këtë projekt nuk janë parashikuar hidrantet e zjarrit ose sistemi i automatik i shuarjes së zjarri (sprinklerat). Këto janë konsideruar si të panevojshëm në këtë projekt sepse pjesa më e madhe e proceseve të punës në këtë fabrike kryhen në prezencën e ujit. Pajisjet e levizshme të shuarjes së zjarrit, bombolat portative (shkume, pluhur, gaz) aplikohen në përgjithësi në të gjithë ambientet ku ka panele elektrike dhe transformatorë tensioni.

5.1.4. Impianti i shkarkimit të ujravë të zeza

Ky sistem vetëkuptohet shërben për shkarkimin e ujrave të zeza nga ambientet hidrosanitare të godinave. Në këtë objekt për arsye të numrit të vogël të punonjësve dhe përmasave relativisht të vogla të strukturës është parashikuar vetëm një ambient sanitar, shkarkimet e të cilit do të behen në një gropë septike. Ambienti sanitar është parashikuar të ndërtohet pranë laboratorit të analizave kimike.

5.1.5. Impianti i furnizimit me ujë

Furnizimi me ujë i fabrikës është tepër i rëndësishëm pasi i gjithë procesi teknologjik kryhet në prezencën e ujit. Për të siguruar sasinë e nevojshme të ujit për procesin teknologjik shërben stacioni i pompimit, i cili ndodhet pranë përroit të Leshnicës në pjesën e poshtme të fabrikës. Përveç këtij stacioni do të ndërtohet edhe një stacion tjetër pompimi, i cili do të bëjë të mundur riciklimin e ujit në procesin teknologjik. Nëpërmjet prurjes dhe presionit që ka rrjeti kryesor bëhet furnizimi i makinerive të ndryshme të procesit të vendosura në ambientet teknike.

Dimensionimi dhe projektimi i të gjithë komponenteve dhe aksesoreve të sistemit të furnizimit dhe të shpërndarjes të ujit është realizuar duke marrë në konsideratë elementet mëposhtëm:

[Signature]
GENG. MAH
KONSIDERATË ELEMENTË
DR. GENG MAH
"STRUKTOR" EIC, K 44
13

- Skema e shpërndarjes;
- Përcaktimi i prurjes nominale për çdo makinë dhe dimensionimi i tubove;
- Dimensionimi i tubacioneve magjistrale dhe ato të riqarkullimit;
- Prurja totale nominale;
- Prurja projektuese;
- Presioni i punës
- Humbjet gjatësore njësi të presionit;
- Shpejtësia max. e qarkullimit të ujit;
- Dimensionimi i stacionit të pompimit

Nga stacioni i pompimit i cili ndodhet në pjesën më të poshtëme të gjithë objektit, pranë Përroit të Leshnicës do të pompohet uji për në proces nga pompat e ujit me këto karakteristika: $Q = 15 \text{ m}^3/\text{orë}$, $H = 135 \text{ m}$, $N = 14,5 \text{ Kw}$ me Diametër të brendëshëm 50 mm. Pompat që do të instalohen në stacionin kryesor të pompimit të fabrikës që ndodhet pranë dampës do të jenë me këto karakteristika: $Q = 30 \text{ m}^3/\text{ore}$, $H = 40 \text{ m}$, $N = 30 \text{ kw}$, të cilat do të furnizojnë të gjitha makineritë dhe pajisjet që kanë nevojë për ujin teknologjik.

Për të siguruar furnizim të pandërprerë të fabrikës me ujë do të instalohen nga dy pompa të tilla me karakteristika të njejta, nga të cilat njera do të jetë në punë ndërsa tjetra në riparim dhe rezervë, në të dy stacionet e pompimit.

Për furnizimin e fabrikës me ujë të pijshëm është identifikuar një burim në afërsi të fabrikës i cili do të sistemohet në një linjë të vecantë.

5.1.6. Impjanti i shkarkimit të ujrave të shiut


Ky sistem shërben për shkarkimin e ujërave të shiut dhe përbëhet nga sistemi i piletave dhe kolonave të mbledhjes së ujrave. Të gjithë ujrata e shirave së bashku me rrjedhjet aksidentale të ujërave teknologjike do të mblidhen dhe do të dërgohen në dampën e ndërtuar pranë fabrikës dhe do të qarkullohen në proces.

5.2. Hapësirat e lira dhe të gjelbërta

Hapësirat e lira do të pyllëzohen me pemë të përshtatëshme për zonën dhe lartësinë nga niveli i detit. Si këto hapësira ashtu edhe hapësirat që nuk i përkasin fabrikës, por ndodhen në afërsi të saj dhe janë të pa pyllëzuara do të mbillen me pemë të përshtatëshme për zonën ku po ndërtohet ky objekt. Ndonëse fabrika nuk ndodhet në zonën e halorëve, por ndodhet pranë saj do të mbillen jo vetëm lisa dhe rrepe, por edhe pisha të përshtatëshme për këtë zonë. Parashikohet që në hapësirat e lira të fabrikës dhe në zonën rreth saj të mbillen rreth 100 pemë.

6. Fazat e zhvillimi të Lejes së Ndërtimit

Ndërtimi i fabrikës do të ndjekë vetëm një fazë zhvillimi. Periudha kohore e parashikuar nga fillimi deri në përfundimin e punimeve sipas grafikut të punimeve parashikohet rreth 7 muaj dhe përfshin: ndërtimin e bazamenteve, rrugëve të brendëshme, linjën elektrike të tensionit të lartë, stacionet e pompave dhe linjën e ujit teknologjik, montimin e makinerive dhe instalimet teknologjike. Me përfundimin e tyre, fabrika do të vihet në punë. Bashkëngjitur këtyre materialeve është paraqitur edhe grafiku i rishikuar të realizimit të punimeve.


 NR. LICENCE 0044
 K. 0517

7. Relacioni i menaxhimit të inerteve të dala si rezultat i punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit

Për ndërtimin e strukturës së objekteve që propozohen nevojitet kryerja e punimeve të gërmimit. Këto gërmime do të shërbejnë për mbështetjen e strukturave të betonit të armuar, të cilat nga ana e tyre do të shërbejnë njëkohësisht edhe si dysheme të reparteve të fabrikës.

Volumi i dherave që do të dalë nga gërmimi në sasinë rreth 10 000 m³ do të përdoret thuajse tërësisht brenda objektit. Sasia prej 4000 m³ do të shërbejë për nivelimin e shesheve masive të depozitimit të mineralit dhe koncentratit, ndërsa sasia tjetër prej 6000 m³ do të përdoret për krijimin e digës së dampës së sterileve.

8. Impaktet Kryesore në Mjedis

8.1. Impakt mbi sipërfaqen e tokës

Vendi, objektet dhe infrastruktura inxhinierike, ku realizohen ndryshimet e propozuara është një zonë e çveshur dhe e pa përdorshme qoftë për kullota ashtu edhe për rritje të pyjeve.

8.2. Impakt mbi ujërat sipërfaqësore


Aktivitetet e ndërtimit/montimit mund të ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore nga rrjedhja (humbjet) ose derdhjet aksidentale të lëndëve djegëse, vajrave, substancave kimike të ndryshme, etj.

Për të shmangur/minimizuar ndotjen, materialet e lartpërmendur, do të depozitohen në sheshe depozitimi të posaçme; procedurat e punimeve do të sigurojnë që këto materiale të përpunohen në mënyrë korrekte.

Edhe gjatë shfrytëzimit mund të ekzistojnë të njejtat risqe për ndotjen e mjedisit, por në këtë rast procesi është më i kontrolluar dhe më i organizuar e për pasojë edhe probabiliteti për dëmtime aksidentale është shumë më i vogël. Do të ketë vende të caktuara për ruajtjen e karburanteve dhe vajrave si të atyre që do të përdoren në proces ashtu edhe për ato vajra që do të rigjenerohen. Në ambjentin e ofiçinës është parashikuar një sipërfaqe e veçantë për mbajtjen e vajrave të reja dhe të atyre të përdorura që pasi do të arrijnë sasinë 180 litra do të spostohen në vendet e caktuara të përpunimit të tyre. Ujërat e tjera të procesit që mund të rrjedhin në mënyrë aksidentale nuk mund të shkaktojnë asnjë dëm për ujërat sipërfaqësore të zonës për dy arsye: së pari janë ujëra të pastra dhe pa elemente të dëmshëm për mjedisin dhe së dyti do të kanalizohen për në dampë, ku do të dekantohen për çdo të ngurtë që mund të ndodhet në të.

8.3. Impakt mbi ujërat nëntokësore

Ujërat që rezultojnë nga procesi teknologjik dhe që mund të ndikojnë në ujërat nëntokësore janë parashikuar që të arrijnë parametrat e lejuar, si në drejtim të PH-it, përmbajtjes së masës së ngurtë ashtu edhe elementave të dëmshëm, ballafaquar me normat ligjore të shkarkimeve të ujërave industriale, për industrinë minerare të pasurimit. Duhet përmendur edhe një herë fakti se në procesin teknologjik të kësaj fabrike nuk përdoret asnjë lloj kimikati.


GENC MADHI
VLERESUES PASURIS
NR. LICENCE 0046
"ONSTRUKTOR LIC. 15 05

8.4. Impakt mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)

8.4.1. Flora dhe Fauna

Zona siç është përshkruar dhe më lartë, është një zonë jo e banuar, në afërsi të minierave ekzistuese dhe me përmasa jo të medha që të mund të ndikojë në florën dhe faunën e zonës. Nga relacioni "Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis" rezultojnë:

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Po	Jo
Në florën dhe faunën		
Shkatërrim i rëndësishëm i habitateve natyrore		X
Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë në zonat e virgjëra		X
Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit		X
Përcarje/izolim habitateve të egra		X
Interferenca midis rrugëve natyrore të emigrimit të sisorëve		X

8.4.2. Habitatet (objekte me status të cilesuar)

Parcela e zgjedhur për projektin në fjalë do të zhvillohet brenda zonës së miratuar dhe në afërsi të saj nuk ndodhet, sipas Studimit "Vlerësimi i ndikimit në Mjedis" asnjë Habitat (Objekte me status të cilësuar).

8.5. Impakt mbi menaxhimin e tokës dhe mbetjeve

Sipërfaqja në të cilën do të zhvillohet veprimtaria është një sipërfaqe e çveshur toke e cila duke pasur parasysh përbërjen e saj nuk mund të përdoret për tokë bujqësore. Sipas Studimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ushtrimi i aktivitetit në këtë zonë nuk ndikon negativisht në sasinë dhe cilësinë e tokës.

8.5.1. Mbetje të ngurta


Prodhimi i koncentratit të kromit është i lidhur me gjenerimin e disa mbetjeve dhe hedhurinave që janë të listuara në Katalogun Shqiptar të Mbetjeve (i hartuar në përputhje me Katalogun Evropian të Mbetjeve). Mbetjet e ngurta më të rëndësishme, thuajse tërësisht, janë sterilet e formuara në procesin e pasurimit.

8.5.2. Sterile të procesit teknologjik

Në përputhje me përmbajtjen e kromit në mineralin e përdorur, sasia e sterileve për 1 ton koncentrat të prodhuar mund të variojë në vlerat 2.0 ÷ 4.0 ton. Përbërësit kryesorë të sterileve që rezultojnë nga procesi janë: MgO, Al₂O₃, SiO₂, Cr₂O₃, Fe₂O₃, FeO, Kimikishte serilet e gjeneruara nga procesi janë shumë të qëndrueshme. Këto mbetje sterile që dalin nga procesi teknologjik në sasinë rreth 48.000 ton/vit do të depozitohen në venddepozitimin e paraqitur dhe përshkruar në projekt, në Dampen që do të ndërtohet për këtë qëllim.

Shkëmbinjtë ultrabazikë që përbëjnë zonën ku do të ngrihet fabrika dhe dampa janë të përshtatshëm për depozitimin e mbetjeve dhe nuk kanë çarje të mëdha apo zgavra që të lejojnë filtrimin e tyre në thellësi, përkundrazi çarjet e tyre të dendura por të ngushta do të mbushen që në fillim dhe me kalimin e ujit ato do të çimentohen dhe do të bëhen si një bazament homogjen. Kjo është praktika thuajse në tërësi dampa e sterileve që janë në punë.

Për shkak edhe të karakteristikave të përshtatshme që zotërojnë, sterilet që rezultojnë nga prodhimi i koncentrateve të kromit mund të përdoren si material ndërtimi. Duke pasur


Gjenerues PASURITSH
NR. LICENCE 0044
STRUKTOR LIC. K. 0517

parasysh afërsinë e kësaj fabrike me qytetin e Kukësit dhe me Kosovën në të ardhmen edhe përdorimi i sterileve mund të jetë një mundësi shtesë.

8.6. Impakt mbi Peizazhin

Pejsazhi nuk do të dëmtohet nga ndërtimi i objekteve, pasi ato do të ndërtohen në harmoni me mjedisin rrethues. Aktiviteti nuk paraqet ndonjë ndikim të madh direkt apo indirekt në mjedis.

8.7. Impakt mbi Zhurmat dhe ajrin

8.7.1. Ndikimet në zhurma dhe vibrime

Ushtrimi i këtij aktiviteti do të shoqërohet dhe nga zhurmat e shkaktuara nga makineritë teknologjike si dhe ato të transportit. Zhurmat e çliruara do të jenë brenda normave dhe standarteve të miratuara për këtë qëllim, ndonëse në afërsi të zonën ku do të ndërtohet fabrika nuk ka asnjë zonë të banuar. Niveli i zhurmave në këtë fabrikë nuk do ta kalojë nivelin 80 dB. Arsyeja e këtij niveli relativisht të ulët është se mullinjtë që realizojnë bluarjen e mineralit do të jenë me veshje gome për arsye teknologjike dhe si rezultat do të ndikojnë edhe në uljen e nivelit të zhurmave.

Përsa i takon problemeve të vibrimeve që lidhen me punën e makinerive të rënda, ato do të jenë përsëri brenda normave, por janë tepër minimale dhe nuk merren në konsideratë

Sipas studimit "Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis" rezulton si më poshtë:

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo
Nga zhurmat		
Rritja e nivelit egzistues të zhurmave	X	
Rritja e nivelit të zhurmave si rezultat i aktivitetit dhe makinerive	X	
Rritja e nivelit të zhurmave për njerëzit	X	
Nivel më i lartë i zhurmave për kafshët		X

8.7.2. Ndikimi në ajër

Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ketë aspak ndikim në cilësinë e ajrit të zonës pasi sasia e pluhurave që mund të clirohen gjatë shfrytëzimit do të jenë jo vetëm brenda normave, sipas Ligjit Nr 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", por mjaft minimale në vlera më të vogla se 5 mg/m³N. Sidoqoftë subjekti ka marrë edhe masa suplementare në këtë aspekt dhe nga më kryesoret është përdorimi i sprucimit të ujit gjatë procesit të thyerjes. Gjithë proceset e tjera zhvillohen në të lagët, kështu që nuk ka asnjë mundësi për krijimin e pluhurave shtesë. Gjatë punës së kësaj fabrike nuk ka emetim të asnjë lloj gazi. Duhet me theksuar gjithashtu se në këtë fabrikë nuk përdoret asnjë lloj kimikati ose substancë e dëmshme për mjedisin.

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo
Ne ajër		
Prodhimi i pluhurit	X	

GENC MADHI
VLERESUES PASURISH
NR. LICENCE 0044
KOSOVË
17


Ndotje nga djegia e hidrokarbureve		X
Ndotje nga CO, SO ₂ , NO _x		X

8.8. Impakt mbi trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë

Në zonën e shfrytëzuar, nuk janë parashikuar masa lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e zonave arkeologjike apo historike, pasi nuk ka të tilla në të. Kryerja e punimeve në këtë zonë është miratuar me vendimin nr. 104, datë 11.11.2014 të Ministrisë së Kulturës dhe me Shkresën nr. 348, datë 21.05.2015 të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

9. Anekset A3 (harta)

- Plani Organizimit të Punimeve dhe Grafiku i Punimeve;
- Planimetria Vendosijes së Makinerive;
- Skema Teknologjike;
- Pamje perspektive të zhvillimit.



GENC MADHI
VLERESUES PASURISH
 NR. LICENC **0044**
 KONSTRUKTOR L.C. K. 0517